



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.404/ 6 prot

Datë 19.02.2026

V E N D I M

Nr. 282/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.02.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Vitanet Albania” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-72602-12-17-2025, me objekt: “Loti 1 Isoflurane Inhalation vapour, Liquid x 100 ml Flakon”, me fond limit 3,978,635.50 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 19.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara

Ankimues: “Vitanet Albania” SHPK me NIPT K92201080V dhe adresë: *Rr. Njesia Bashkiake nr 8, Rruga Siri Kodra, ndertese 2-kateshe, me zone kadastrale 8340 dhe nr pasurie 8/660, kati 1, Tirane*

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve te Perqendruara me adresë: *Rruga “Reshit Collaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë)*

Subjekte të Interesuara: “Medicamenta” SHPK me NIPT K41420001V dhe adresë: *Tiranë, Kashar, Autostrada Tirane Dures, Km 6, Ndertesa dy kateshe nr. 5, kati i I i nderteses, prane Poseidon*

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:**I***Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 18.12.2025 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-72602-12-17-2025, me objekt: “Loti 1 Isoflurane Inhalation vapour, Liquid x 100 ml Flakon”, me fond limit 3,978,635.50 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 19.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara.

II.2. Në datën 19.01.2026, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 27.01.2026 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave për vlerat pa TVSH si më poshtë:

1. OE "Medicamenta" shpk	me vlerë	3,281,800	kualifikuar
2. OE "Vitanet Albania" shpk	me vlerë	3,952,800	kualifikuar
3. OE "Incomed" shpk	me vlerë	3,977,200	skualifikuar

II.4. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elektronike rezulton, se më datë 04.02.2026 është publikuar njoftimi i fituesit paraprak për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Në datën 07.02.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6310, si dhe nr. 404/2026 prot., datë 09.02.2026, i operatorit ekonomik "Vitanet Albania" SHPK për procedurën e prokurimit "E hapur, mbi kufirin e lartë monetar" me Nr. REF-72602-12-17-2025, me objekt: "Loti 1 Isoflurane Inhalation vapour, Liquid x 100 ml Flakon", me fond limit 3,978,635.50 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 19.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Pergendruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik "Medicamenta" SHPK në procedurën e prokurimit të sipërcituar konkretisht duke pretenduar:

“

Ne shtojcen 9, pika 2. Kriteret e vecanta te kualifikimit te DST kerkohet:

4. Për barnat (e listës së DST) të autorizuar për tregtim në Republikën e Shqipërisë, duhet të paraqitet:

- dokumenti i cili konfirmon se bari i ofertuar, është i pajisur me autorizim për tregtim në Republikën e Shqipërisë, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore /ose/

- autorizimi për tregtim i barit, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, brenda afatit të tij të vlefshmërisë.

5. Për barnat (e listës së DST) të paautorizuara për tregtim në Republikën e Shqipërisë, bari që ofertohehet duhet:

a. të ketë marrë autorizim për tregtim dhe të qarkullojë në njërin nga vendet e Bashkimit Evropian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanada, Turqi, Zvicër, Izrael, Japoni, Australi, Norvegji, Islandë dhe Mbretëri e Bashkuar;

/ose/

b. të jetë i prodhuar në vendet e Ballkanit, vetëm nëse ka marrë autorizim për tregtim dhe qarkullon në vendin e tij,

/ose/

c. të jetë i pajisur me autorizim për tregtim nga Agjencia Evropiane e Barnave (EMA), ose Institucioni i Administrimit për Ushqimin dhe Barnat (FDA) i Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Për këtë kërkohet që ofertuesi të paraqesë:

- Deklaratë me anën e të cilës të konfirmohet se bari që ofron, është i pajisur me autorizim për tregtim dhe qarkullon në një nga vendet e mësipërme (të Bashkimit Evropian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanada, Turqi, Zvicër, Izrael, Japoni, Australi, Norvegji, Islandë dhe Mbretëri e Bashkuar), ose që disponon autorizim për tregtim nga FDA ose EMA.

Në deklaratën e nëshkruar dhe të vulosur nga ofertuesi duhet të deklarohen: Emri dhe adresa e plotë e Institucionit/eve të autorizuar që kanë lëshuar autorizimin për tregtim; Të dhëna kontakti për këto institucione (Tel, fax, e-mail, web-site); Numri dhe data e lëshimit të autorizimit për tregtim (nga Institucioni/et të autorizuar) të barit që ofron dhe periudhën e vlefshmërisë të këtij autorizimi.

Bazuar në informacionin mbi barnat e pajisura me autorizim tregtimi në Republikën e Shqipërisë të Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (të publikuar/perditesuar në datë 15.12.2025), rezulton se për principin aktiv Isoflurane 100 ml ekziston vetëm një alternativë e regjistruar:

Emri Tregtar	Principi aktiv	Forme Doza	Paketimi	Mbajtësi i Autorizimit për Tregtim	Prodhuësi	Urdhi i Ministrit/Data
NESTERA	Isoflurani	Inhalation vapour, liquid x 100 ml	Box x 1 glass bottle x 100 ml	S.C Rompharm Company srl – Rumani	S.C.Rompharm Company S.R.L.(Str. Eroilor Nr. 1a) - Rumani;	RI/AUTORIZIM/ TREGTIMI 535/31.10.2025

Meqenëse për këtë bar, shoqëria Vitanet Albania është distributor i autorizuar për territorin e Shqipërisë për të cilin edhe kemi paraqitur ofertë në këtë procedurë, duke dorëzuar dokumentacionin përkatës të kërkuar në DST, Kriteret e vecanta pika 4 - Certifikatë regjistrimi, dhe pika 6. Autorizim të vlefshëm nga MAH S.C Rompharm, ne kemi pretendime se dy OE të tjera Medicamenta shpk dhe Incomed shpk kanë paraqitur ofertë për barna të paautorizuara për tregtim në territorin e Shqipërisë.

Vendimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e OE Medicamenta bie ndesh me dispozitat e Ligjit nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik” dhe VKM nr. 142, datë 18.02.2015 “Për përcaktimin e rregullave për lëshimin e autorizimit të ministrit të shëndetësisë për importimin e barnave pa autorizim për tregtim”, të cilat përcaktojnë qartë rregullat për autorizimin e tregtimit dhe importin e barnave pa autorizim.

Sipas nenit 11, pika 2, importi i barnave pa autorizim behet vetem ne raste nevojash te sherbimit shendetesor dhe vetem kur nuk ekziston asnje alternative e ngjashme e pajisur me autorizim tregtimi nga Agjencia Kombetare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekesore (AKBPM).

Per me teper, neni 33, pika 1 dhe 3 percakton se autorizimi i ministrit jepet vetem per barnat per te cilat nuk eshte leshuar autorizim tregtimi nga AKBPM dhe per çdo seri te veçante, duke respektuar kriteret e percaktuara me vendim te Keshillit te Ministrave.

Sipas VKM nr. 142/2015, pika 1 dhe 3 sakteson se autorizimi per importin e barnave pa autorizim per tregtim mund te jepet vetem kur nuk ekziston asnje alternative e autorizuar nga AKBPM.

Ne rastin konkret, per barin Isoflurane, ekziston nje alternative e regjistruar dhe e autorizuar nga AKBPM, e ofruar nga OE Vitanet Albania shpk i cili disponon autorizim te vlefshem tregtimi. Gjithashtu ky bar importohet dhe tregtohet rregullisht ne territorin e Shqiperise dhe per kete bar jane lidhur ne vazhdimesi kontrata furnizimi me spitalet publike.

Pavaresisht ketij kuadri te qarte ligjor, Komisioni i Vleresimit te Ofertave ka kualifikuar oferten per Lot 1-Isoflurane te OE Medicamenta shpk, duke zbatuar ne menyre te gabuar dispozitat ligjore qe lejojne importin e barnave te paautorizuara **vetem ne mungese absolute te alternativave te regjistruara**, kusht qe ne kete rast nuk ekziston.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.404/1 prot., datë 09.02.2026.

II.7. Përmes shkresës me nr. 4283/32 prot., datë 17.02.2026 protokolluar me tonën me nr. 404/2 prot., datë 17.02.2026 autoriteti kontraktor ka ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike vendimin për shqyrtimin e ankesës “Vendim K.SH.A 22/2026” datë 17.02.2026 përmes të cili ka vendosur pranimin e plotë të saj duke argumentuar:

“[...]

II.

Komisioni i shqyrtimit të ankesës

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit të paraqitur në SPE si dhe informacionit të vendosur në dispozicion nga njësia e prokurimit:

ARSYETON:

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Vitanet Albania” shpk mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Medicamenta” shpk *me arsyen se kjo shoqëri ka paraqitur ofertë për barna të paautorizuara për tregtim në territorin e Shqipërisë*, KSHA arsyeton se:

Në Dokumentet e Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 2.3 “Kapaciteti teknik”, nën-pika 4 dhe 5 është përcaktuar se:

“4. Për barnat (e listës së DST) të autorizuar për tregtim në Republikën e Shqipërisë, duhet të paraqitet:

- dokumenti i cili konfirmon se bari i ofertuar, është i pajisur me autorizim për tregtim në Republikën e Shqipërisë, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore /ose/

- autorizimi për tregtim i barit, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, brenda afatit të tij të vlefshmërisë.

5. Për barnat (e listës së DST) të paautorizuara për tregtim në Republikën e Shqipërisë, bari që ofertohet duhet:

a. të ketë marrë autorizim për tregtim dhe të qarkullojë në njërin nga vendet e Bashkimit Evropian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanada, Turqi, Zvicër, Izrael, Japoni, Australi, Norvegji, Islandë dhe Mbretëri e Bashkuar;

/ose/

b. të jetë i prodhuar në vendet e Ballkanit, vetëm nëse ka marrë autorizim për tregtim dhe qarkullon në vendin e tij,

/ose/

c. të jetë i pajisur me autorizim për tregtim nga Agjencia Evropiane e Barnave (EMA), ose Institucioni i Administrimit për Ushqimin dhe Barnat (FDA) i Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Për këtë kërkohet që ofertuesi të paraqesë:

- Deklaratë me anën e të cilës të konfirmohet se bari që ofron, është i pajisur me autorizim për tregtim dhe qarkullon në një nga vendet e mësipërme (të Bashkimit Evropian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanada, Turqi, Zvicër, Izrael, Japoni, Australi, Norvegji, Islandë dhe Mbretëri e Bashkuar), ose që disponon autorizim për tregtim nga FDA ose EMA.

Në deklaratën e nëshkruar dhe të vulosur nga ofertuesi duhet të deklarohen: Emri dhe adresa e plotë e Institucionit/eve të autorizuar që kanë lëshuar autorizimin për tregtim; Të dhëna kontakti për këto institucione (Tel, fax, e-mail, web-site); Numri dhe data e lëshimit të autorizimit për tregtim (nga Institucioni/et të autorizuar) të barit që ofron dhe periudhën e vlefshmërisë të këtij autorizimi.”

Në Nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;

b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale....

Në nenin 21, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, citohet shprehimisht: “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të

barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

Në Nenin 36 “Specifikimet teknike”, të Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, përcaktohet se: “1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

7. Autoriteti ose enti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike, referuar parashikimeve të mësipërme, kryen verifikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sisteme të tjera kombëtare në rast se ekzistojnë standarde kombëtare ose ndërkombëtare në fuqi për mallrat, punët dhe shërbimet. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuar të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara në përputhje me parashikimet evropiane.

Në pikën 1, 4 dhe 5 të nenit 77, "Kërkesat për kualifikim", të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", parashikohet se:

"1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve".

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës pasi mori në shqyrtim dokumentacionin e dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik "Medicamenta" shpk si dhe dokumentacionin e dorëzuar fizikisht pranë Autoritetit Kontraktor, konstaton se ai në përmbushje të kriterit të sipërcituar, konkretisht pikën 2.3.5, ka paraqitur dokumentacionin me emërtimet si më poshtë:

- 1- *Autorizim prodhuesi*
- 2- *Deklaratë mbi autorizimin për tregtim të barit Isoflurane*
- 3- *Deklaratë mbi origjinën e mallit*

Nga verifikimi dokumenteve të mësipërme rezulton se OE ka paraqitur deklaratë me anën e së cilës deklaron se bari që oferton, është i pajisur me autorizim për tregtim dhe qarkullon në një nga vendet Bashkimit Evropian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanada, Turqi, Zvicër, Izrael, Japoni, Australi, Norvegji, Islandë dhe Mbretëri e Bashkuar) dhe disponon autorizim për tregtim nga FDA ose EMA. Në deklaratë janë deklaruar: Emri dhe adresa e plotë e Institucionit/eve të autorizuar që kanë lëshuar autorizimin për tregtim; Të dhëna kontakti për këto institucione (Tel, fax, e-mail, web-site); Numri dhe data e lëshimit të autorizimit për tregtim (nga Institucioni/et të autorizuar) të barit që ofron dhe periudhën e vlefshmërisë të këtij autorizimi. Gjithashtu OE ka dorëzuar autorizim nga prodhuesi për artikullin objekt prokurimi.

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Referuar procedurës në fjalë të prokurimit "*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*", me Numër reference të procedurës/Lotit: REF-72599-12-17-2025 me objekt kryesor "*Blerje barna për mbulimin e nevojave për një periudhë 24 mujore në Q.S.R.T 'Shefqet Ndroqi', e ndarë në lote*", konstatohet se kjo procedurë është e ndarë në 75 (shtatëdhjetë e pesë) Lote, ku kriteret e vecanta të kualifikimit janë hartuar për të gjitha lotet njësoj. Në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastin konkret, kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.4 të Kapacitetit teknik përcakton qartë dokumentacionin që duhet plotësuar në rastin kur në Republikën e Shqipërisë rezulton një bar i regjistruar i autorizuar për tregtim dhe

nëse nuk do të rezultonte asnjë autorizim për tregtim në Republikën e Shqipërisë lidhur me barin *Isoflurane Inhalation vapour, Liquid x 100 ml Flakon*, atëherë do të ndodheshim në kushtet e përmbushjes së pikës 2.3.5 të Kapacitetit Teknik.

KSHA verifikoi listën e barnave të autorizuara për tregtim në territorin e Republikës së Shqipërisë, publikuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, përditësuar më datë 15.12.2025 dhe konstatoi se ky artikull rezulton i regjistruar me emrin tregtar *ANESTERAN* me princip aktiv *Isofluranum*. KSHA gjykon se për sa kohë ky produkt regjistrohet/autorizohet për tregtim/përdorim në Republikën e Shqipërisë, atëherë operatori ekonomik i shpallur fitues paraprak i procedurës ka patur mundësinë e regjistrimit të tij dhe pajisjen me dokumentin *Autorizim për tregtim në Republikën e Shqipërisë* konform përcaktimeve ligjore. Dokumenti i paraqitur nga operatori ekonomik i shpallur fitues paraprak, në formë deklarate, nuk dëshmon dhe garanton realizimin me sukses të kontratës për sa kohë nuk mund të importojë produktin objekt prokurimi duke qenë se nuk disponon dokumentin *Autorizim për Tregtim*.

Kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë, të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimes do të kishte paqartësi në lidhje me plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarim pranë OPB-së parashikuar nga pika 1 e nenit 75 të LPP-së ku përcaktohet se: *“1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. [...]”*.

Artikulli *Isofluran* përdoret për kryerjen e anestezisë së përgjithshme gjatë operacioneve, pra është i një rëndësie të veçantë dhe në dokumentet e tenderit është përcaktuar që 20% e sasisë së këtij artikulli të lëvrohet 15 ditë nga nënshkrimi i kontratës, mosrealizimi i së cilës do të sillte efekte anësore për mirëfunksionimin e sallave operative. *Isofluran* është produkt farmaceutik/anestezik që kërkon autorizim të posaçëm për tregtim dhe shpërndarje. Mungesa e këtij autorizimi përbën mospërmbushje thelbësore ligjore dhe teknike. *Isoflurani* klasifikohet si bar (produkt medicinal). Tregtimi i barnave në Shqipëri lejohet vetëm për subjekte që kanë Licencë për tregtim me shumicë të barnave dhe Autorizim nga AKBPM. Në rastin konkret, operatori ekonomik “Medicamenta” shpk nuk e posedon autorizimin për tregtim në Republikën e Shqipërisë, në kundërshtim të drejtpërdrejtë me legjislacionin farmaceutik. Kontraktimi i një operatori pa autorizim do të sillte përgjegjësi institucionale dhe pasoja ligjore në rast incidenti klinik. Mungesa e këtij dokumenti nënkupton mungesë të kapacitetit ligjor për ushtrimin e aktivitetit. Sipas Ligjit Nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, tregtimi me shumicë i barnave kryhet vetëm nga subjekte të pajisura me licencë përkatëse dhe ushtrimi i aktivitetit pa licencë përbën shkelje administrative.

Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të

transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

KSHA gjykon se mosdisponimi i dokumentit Autorizim për Tregtim sjell rrjedhimisht mosfurnizimin sipas afateve të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gjë e cila, për Spitalin "Shefqet Ndroqi" do të sillte pasoja substanciale në funksionimin e sallave operative. Rrjedhimisht, KSHA gjykon se operatori ekonomik "Medicamenta" shpk nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.4 të Kapacitetit teknik të DT.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 114 ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe nenit 102 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës,

VENDOSI

1. Pranimin e plotë të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik "Vitanet Albania" shpk.
2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.
4. Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të Organit Qëndror Blerës.

II.8. Vendimin për shqyrtimin e ankesës autoriteti kontraktor e dërgoi në KPP edhe përmes shërbimit postar i cili u protokollua me tonën me nr.404/ 3 prot., datë 19.02.2026.

II.9. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ nuk rezulton të jenë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara në kuptim të nenit 113 *te lex specialis* në sistemin e ankesave elektronike.

III

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "Vitanet Albania" SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik "Medicamenta" SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Përmes shkresës me nr. 4283/32 prot., datë 17.02.2026 protokolluar me tonën me nr. 404/2 prot., datë 17.02.2026 autoriteti kontraktor ka ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike vendimin për shqyrtimin e ankesës “Vendim K.SH.A 22/2026” datë 17.02.2026 përmes të cili ka vendosur pranimin e plotë të saj duke argumentuar:

“[...]

II.

Komisioni i shqyrtimit të ankesës

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit të paraqitur në SPE si dhe informacionit të vendosur në dispozicion nga njësia e prokurimit:

ARSYETON:

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Vitanet Albania” shpk mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Medicamenta” shpk me arsyen se *kjo shoqëri ka paraqitur ofertë për barna të paautorizuara për tregtim në territorin e Shqipërisë*, KSHA arsyeton se:

Në Dokumentet e Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 2.3 “Kapaciteti teknik”, nën-pika 4 dhe 5 është përcaktuar se:

“4. Për barnat (e listës së DST) të autorizuar për tregtim në Republikën e Shqipërisë, duhet të paraqitet:

- dokumenti i cili konfirmon se bari i ofertuar, është i pajisur me autorizim për tregtim në Republikën e Shqipërisë, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore /ose/*

- autorizimi për tregtim i barit, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, brenda afatit të tij të vlefshmërisë.*

5. Për barnat (e listës së DST) të paautorizuara për tregtim në Republikën e Shqipërisë, bari që ofertohet duhet:

- a. të ketë marrë autorizim për tregtim dhe të qarkullojë në njërin nga vendet e Bashkimit Evropian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanada, Turqi, Zvicër, Izrael, Japoni, Australi, Norvegji, Islandë dhe Mbretëri e Bashkuar;*

/ose/

- b. të jetë i prodhuar në vendet e Ballkanit, vetëm nëse ka marrë autorizim për tregtim dhe qarkullon në vendin e tij,*

/ose/

- c. të jetë i pajisur me autorizim për tregtim nga Agjencia Evropiane e Barnave (EMA), ose Institucioni i Administrimit për Ushqimin dhe Barnat (FDA) i Shteteve të Bashkuara të Amerikës.*

Për këtë kërkohet që ofertuesi të paraqesë:

- Deklaratë me anën e të cilës të konfirmohet se bari që ofron, është i pajisur me autorizim për tregtim dhe qarkullon në një nga vendet e mësipërme (të Bashkimit Evropian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanada, Turqi, Zvicër, Izrael, Japoni, Australi, Norvegji, Islandë dhe Mbretëri e Bashkuar), ose që disponon autorizim për tregtim nga FDA ose EMA.*

Në deklaratën e nëshkruar dhe të vulosur nga ofertuesi duhet të deklarohen: Emri dhe adresa e plotë e Institucionit/eve të autorizuar që kanë lëshuar autorizimin për tregtim; Të dhëna kontakti për këto institucione (Tel, fax, e-mail, web-site); Numri dhe data e lëshimit të autorizimit për tregtim (nga Institucioni/et të autorizuar) të barit që ofron dhe periudhën e vlefshmërisë të këtij autorizimi.”

Në Nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*

- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*

- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*

- d) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*

- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik*

- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale....

Në nenin 21, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, citohet shprehimisht: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të*

barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

Në Nenin 36 “Specifikimet teknike”, të Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, përcaktohet se: “1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

7. Autoriteti ose enti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike, referuar parashikimeve të mësipërme, kryen verifikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sisteme të tjera kombëtare në rast se ekzistojnë standarde kombëtare ose ndërkombëtare në fuqi për mallrat, punët dhe shërbimet. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuar të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara në përputhje me parashikimet evropiane.

Në pikën 1, 4 dhe 5 të nenit 77, "Kërkesat për kualifikim", të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", parashikohet se:

"1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve".

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës pasi mori në shqyrtim dokumentacionin e dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik “Medicamenta” shpk si dhe dokumentacionin e dorëzuar fizikisht pranë Autoritetit Kontraktor, konstaton se ai në përmbushje të kriterit të sipërcituar, konkretisht pikën 2.3.5, ka paraqitur dokumentacionin me emërtimet si më poshtë:

- 1- *Autorizim prodhuesi*
- 2- *Deklaratë mbi autorizimin për tregtim të barit Isoflurane*
- 3- *Deklaratë mbi origjinën e mallit*

Nga verifikimi dokumenteve të mësipërme rezulton se OE ka paraqitur deklaratë me anën e së cilës deklaron se bari që oferton, është i pajisur me autorizim për tregtim dhe qarkullon në një nga vendet Bashkimit Evropian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanada, Turqi, Zvicër, Izrael, Japoni, Australi, Norvegji, Islandë dhe Mbretëri e Bashkuar) dhe disponon autorizim për tregtim nga FDA ose EMA. Në deklaratë janë deklaruar: Emri dhe adresa e plotë e Institucionit/ëve të autorizuar që kanë lëshuar autorizimin për tregtim; Të dhëna kontakti për këto institucione (Tel, fax, e-mail, web-site); Numri dhe data e lëshimit të autorizimit për tregtim (nga Institucioni/et të autorizuar) të barit që ofron dhe periudhën e vlefshmërisë të këtij autorizimi. Gjithashtu OE ka dorëzuar autorizim nga prodhuesi për artikullin objekt prokurimi.

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Referuar procedurës në fjalë të prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Numër reference të procedurës/Lotit: REF-72599-12-17-2025 me objekt kryesor “*Blerje barna për mbulimin e nevojave për një periudhë 24 mujore në Q.S.R.T ‘Shefqet Ndroqi’, e ndarë në lote*”, konstatohet se kjo procedurë është e ndarë në 75 (shtatëdhjetë e pesë) Lote, ku kriteret e vecanta të kualifikimit janë hartuar për të gjitha lotet njësoj. Në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastin konkret, kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.4 të Kapacitetit teknik përcakton qartë dokumentacionin që duhet plotësuar në rastin kur në Republikën e Shqipërisë rezulton një bar i regjistruar i autorizuar për tregtim dhe

nëse nuk do të rezultonte asnjë autorizim për tregtim në Republikën e Shqipërisë lidhur me barin *Isoflurane Inhalation vapour, Liquid x 100 ml Flakon*, atëherë do të ndodheshim në kushtet e përmbushjes së pikës 2.3.5 të Kapacitetit Teknik.

KSHA verifikoi listën e barnave të autorizuara për tregtim në territorin e Republikës së Shqipërisë, publikuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, përditësuar më datë 15.12.2025 dhe konstatoi se ky artikull rezulton i regjistruar me emrin tregtar *ANESTERAN* me princip aktiv *Isofluranum*. KSHA gjykon se për sa kohë ky produkt regjistrohet/autorizohet për tregtim/përdorim në Republikën e Shqipërisë, atëherë operatori ekonomik i shpallur fitues paraprak i procedurës ka patur mundësinë e regjistrimit të tij dhe pajisjen me dokumentin *Autorizim për tregtim në Republikën e Shqipërisë* konform përcaktimeve ligjore. Dokumenti i paraqitur nga operatori ekonomik i shpallur fitues paraprak, në formë deklarate, nuk dëshmon dhe garanton realizimin me sukses të kontratës për sa kohë nuk mund të importojë produktin objekt prokurimi duke qenë se nuk disponon dokumentin *Autorizim për Tregtim*.

Kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë, të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimes do të kishte paqartësi në lidhje me plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarim pranë OPB-së parashikuar nga pika 1 e nenit 75 të LPP-së ku përcaktohet se: “1. *Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. [...]*”.

Artikulli *Isofluran* përdoret për kryerjen e anestezisë së përgjithshme gjatë operacioneve, pra është i një rëndësie të veçantë dhe në dokumentet e tenderit është përcaktuar që 20% e sasisë së këtij artikulli të lëvrohet 15 ditë nga nënshkrimi i kontratës, mosrealizimi i së cilës do të sillte efekte anësore për mirëfunksionimin e sallave operative. *Isofluran* është produkt farmaceutik/anestezik që kërkon autorizim të posaçëm për tregtim dhe shpërndarje. Mungesa e këtij autorizimi përbën mospërmbushje thelbësore ligjore dhe teknike. *Isoflurani* klasifikohet si bar (produkt medicinal). Tregtimi i barnave në Shqipëri lejohet vetëm për subjekte që kanë Licencë për tregtim me shumicë të barnave dhe Autorizim nga AKBPM. Në rastin konkret, operatori ekonomik “Medicamenta” shpk nuk e posedon autorizimin për tregtim në Republikën e Shqipërisë, në kundërshtim të drejtpërdrejtë me legjislacionin farmaceutik. Kontraktimi i një operatori pa autorizim do të sillte përgjegjësi institucionale dhe pasoja ligjore në rast incidenti klinik. Mungesa e këtij dokumenti nënkupton mungesë të kapacitetit ligjor për ushtrimin e aktivitetit. Sipas Ligjit Nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, tregtimi me shumicë i barnave kryhet vetëm nga subjekte të pajisura me licencë përkatëse dhe ushtrimi i aktivitetit pa licencë përbën shkelje administrative.

Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të

transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

KSHA gjykon se mosdisponimi i dokumentit Autorizim për Tregtim sjell rrjedhimisht mosfurnizimin sipas afateve të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gjë e cila, për Spitalin "Shefqet Ndroqi" do të sillte pasoja substanciale në funksionimin e sallave operative. Rrjedhimisht, KSHA gjykon se operatori ekonomik "Medicamenta" shpk nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.4 të Kapacitetit teknik të DT.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 114 ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe nenit 102 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës,

VENDOSI

1. Pranimin e plotë të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik "Vitanet Albania" shpk.
2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.
4. Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të Organit Qëndror Blerës.

III.1.2. Neni 30 i ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, parashikon se: *"Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera".*

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar parashikon se: *"1.Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;
ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën për dokumentet e tenderit dhe në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/ klasifikimit kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon procedurën për pjesën tjetër të ankesës dhe me mbylljen e shqyrtimit të çështjes duhet të shprehet me vendimmarrje deklarative për pjesën e pranuar sipas parashikimeve të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 118 të këtij ligji, së bashku me vendimmarrje për pjesën tjetër.”

III.1.4. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara në përputhje me parashikimet e nenit 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe për këtë fakt bazuar në nenin 115 të ligjit të sipërcituar KPP do të mbyllë çështjen për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30, 115 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Vitanet Albania” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-72602-12-17-2025, me objekt: “Loti 1 Isoflurane Inhalation vapour, Liquid x 100 ml Flakon”, me fond limit 3,978,635.50 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 19.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.
2. Autoriteti kontraktor të zbatojë vendimin e KSHA-së me nr. 22/2026 datë 17.02.2026 të ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike përmes shkresës me nr. 4283/32 prot., datë 17.02.2026 protokolluar me tonën me nr. 404/2 prot., datë 17.02.2026.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të njoftojë KPP mbi zbatimin e vendimit të KSHA duke dokumentuar veprimet e kryera.

4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Vitanet Albania” SHPK.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro



Vulosur elektronikisht nga Komisioni i
Prokurimit Publik
Date: 2026/02/20 13:59:38 +02'00'
2724e370d83b4dab8c0011826791013f

Digitally signed by
Fiorent ZGURO
Date: 2026.02.20
02:07:17